



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS
TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL



RAPORT TREMUJOR
(tetor – dhjetor 2023)

PËR AKTIVITETET DHE REKOMANDIMET E KOORDINATORIT KOMBËTAR
PËR LUFTIMIN E KRIMIT EKONOMIK

Prishtinë, janar 2024

1. HYRJE – Mandati i Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik

Pozita e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik është krijuar në bazë të një udhëzimi administrativ të lëshuar nga kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) me 27 dhjetor 2013. Personi i emëruar për atë pozitë ka kompetenca dhe përgjegjësi për detyrat në vijim:

1. Koordinimin e aktiviteteve për rritje të vetëdijesimit të të gjitha agjencioneve të përfaqësuara nga nënshkruesit e këtij memorandumi, përmes mediave publike dhe mënyrave tjera, për rreziqet që shoqërohen me dështim dhe benefitet e suksesit të luftimit të krimeve që gjenerojnë dobi pasurore;
2. Mbikëqyrjen e krijimit dhe implementimit të planeve të veprimit, të dizajnuara për të arritur dhe për të mirëmbajtur përputhjen me standardet ndërkombëtare kundër pastrimit të parasë;
3. Koordinimin e reagimit kombëtar ndaj kërkesave të organizatave ndërkombëtare për zhvillim të ekzaminimeve ose vlerësimeve kundër pastrimit të parasë;
4. Mbikëqyrjen e planifikimit dhe implementimit të programeve të trajnimit të përfshira në mandatin e Institutit kundër Krimit Ekonomik (IKE);
5. Identifikimin e mundësive për përmirësim, praktika më të mira dhe procedura operuese që mund të përmirësojnë efikasitetin dhe efektivitetin e programit dhe komunikimin e kësaj informate tek autoritetet e përshtatshme;
6. Grumbullimin dhe analizimin e informatave në lidhje me efikasitetin dhe efektivitetin e entiteteve të involvuara në luftimin e krimeve që gjenerojnë dobi pasurore dhe raportimin e këtyre informatave tek autoritetet e përshtatshme;
7. Sigurimin e mbështetjes administrative dhe funksionale për arritjen e objektivave të strategjive kombëtare për luftimin e pastrimit të parasë, financimit të terrorizmit dhe ekonomisë joformale;
8. Rekomandimin e modifikimeve në strategji kombëtare ose legjislacion që do të përmirësonte përputhjen me standardet ndërkombëtare kundër pastrimit të parasë ose rritjen e efikasitetit apo efektivitetit të programit,
9. Koordinatori Kombëtar do të monitorojë punën e të gjitha institucioneve relevante në R. e Kosovës lidhur me procesimin e rasteve që hyjnë në kuadër të kësaj rregulloreje dhe memorandumit të bashkëpunimit;
10. Koordinatori Kombëtar do të monitorojë dhe do të përcjellë procedimin e rasteve nga institucioni në institucion;
11. Koordinatori mund të propozojë udhëzime për institucionet në fjalë se si të përmirësojnë nivelin e performancës dhe raportimit.
12. Koordinatori Kombëtar ka rol të rëndësishëm në dokumentin e aprovuar nga KPK mbi “Procedurat Standarde të Veprimit për përzgjedhjen e shënjestrave të krimeve të rënda dhe bashkëpunimi ndërinstitucional”;

13. Koordinator Kombëtar po ashtu ka rol edhe në dokumentin tjetër strategjik të aprovuar nga Qeveria e R. së Kosovës “Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare 2024 - 2028” (dokumenti në fjalë është draft strategji).

Prokurori Shqipdon Fazliu, është caktuar nga KPK-ja për këtë pozitë. Ky raport do të bëjë të ditura aktivitetet e tij dhe të entiteteve të involvuara në tri shtyllat e programit të tij: parandalimi dhe detektimi, trajnimi dhe luftimi i krimit ekonomik.

1. ANALIZA&SUKSESET

Periodha e katërt dhe e fundit e vitit 2023, tetor – dhjetor, është kthim në atë që është parë dhe e ka përcjellë sistemin e drejtësisë ndër vite. Pra, në njërin anë ka sekuestrim të konsiderueshëm, mirëpo nuk është raportuar për asnjë konfiskim në këtë periudhë tremujore.

Sipas vlerësimeve të përafërta, vlera e pasurisë së sekuestruar kap shumën e 1,543,996.30 €, ndërsa konfiskimi në këtë periudhë raportuese mbetet pa asnjë rast.

Megjithatë, kjo nuk e zhvelrëson aspak faktin se viti 2023, në tërësinë e tij, mbetet viti më i suksesshëm në sferën e sekuestrimit dhe konfiskimit, ngase vitit 2023 e zë Kosovën me mbi 23.25 milionë euro, që paraqet shumëfishin e pasurisë së konfiskuar në raport me vitet e kaluara.

Në këtë rezultat, më të mirin e arritur ndonjëherë, kanë kontribuar kryesisht dy raste të mëdha, edhe atë, merita kryesore ka të bëjë me rastin që vjen nga PSRK dhe më konkretisht nga prokurori i rastit Naim Abazi, ngase rasti i njohur në opinion si rasti “Banjska”, apo më saktë rasti PPS.nr.75/2023 (në gjykatë i regjistruar në shifrat PPPS.nr.44/2023, i dt. 28.09.2023), është rasti më i madh që kemi pasur ndonjëherë me konfiskim. Veçantia e këtij rasti tejet të madh është se kemi të bëjmë me konfiskimin automatik në bazë të nenit 276 të KPP-së, ndërsa Rasti i dytë evidentohet nën shifrat PPS.nr.59/2019, aktakuzë e ngritur me dt. 12.09.2020, kundër të pandehurit H.P., për shkak të veprave penale, ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike në vazhdim, nga neni 262 paragrafi 1 lidhur me nenin 81, veprës penale të mashtrimit në vazhdim nga neni 335 paragrafi 2 lidhur me nenin 81, mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374.1 dhe veprës penale të shpëlarjes së parave nga neni 302 të KPRK-së e lidhur me nenin 56.1 pika 1.1 të Ligjit nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit (prokurorja e rastit Merita Bina Rugova) ku kemi pasur konfiskim në vlerën prej 2.5 milion euro.

Sa i përket periudhës raportuese tetor – dhjetor 2023, ajo që mund të veçojmë si pozitive gjatë kësaj periudhe tremujore është fakti se konfiskimet, ngrirjet dhe sekuestrimet kanë ndodhur për vepra të ndryshme penale, duke përfshirë veprat penale kundër narkotikëve, krimi i organizuar, organizim i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par 2 lidhur me par 1 të KPRK-së, dhunimi, fajdeja, legalizimi i përmbajtjes së rreme, vjedhja e pyllit, etj..

Më pas është edhe një fakt tjetër pozitiv që tregohet përmes faktit se 30 prokurorë janë përfshirë në sekuestrim, në raste të ndryshme.

-Trendi i zgjidhjes së rasteve të krimeve ekonomike në raport me ato të pranuar gjatë tremujorit të katërt të vitit 2023, është pozitiv nëse krahasohet tërësia e vitit 2023. Të dhënat statistikore dëshmojnë se këtë tremujor janë pranuar gjithsej 103 raste të reja me 144 persona, ndërsa që janë zgjidhur 103 raste me 130 persona.

Përderisa, në vitin 2023, sistemi prokurorial kishte hyrë me 481 raste me 727 persona, viti 2023 po mbyllet me 445 raste me 637 persona.

-Më tutje, përderisa jemi ende te kjo çështje, është interesante të shihet se nga totali prej 130 rasteve të zgjidhura me persona në TM4, prokuroritë themelore dhe PSRK, së bashku, kanë vendosur të ngrisin aktakuza kundër 84 personave, apo në 61%, ndërsa kanë vendosur të pushojnë hetimet kundër 22 personave apo në 20% të tyre, kanë hedhur kallëzimet penale kundër 20 personave apo në 19% të tyre.

- Te vepra penale e shpëlarjes së parave në TM3 të vitit 2023 kemi pasur 2 kallëzime penale të reja të pranuar kundër 10 personave, ndërsa që janë zgjidhur 5 raste me 6 persona. Pra, sikur që vërehet, PSRK ka zgjidhur më shumë raste se sa që ka pranua në raport me rastet.

-Ndërsa kur jemi te vendimet e gjykatave paraqitet një situatë pozitive ngase kemi 28 vendime nga ana e gjykatës. Nga numri prej 28 personave, gjykatat kanë marrë aktgjykime fajësuese kundër 25 personave, në 3 raste është hedhur aktakuza para shqyrtimit gjyqësor, në 0 raste të akuzuarit janë liruar nga aktakuzat dhe në 0 raste është refuzuar aktakuza. Pra, nga totali prej 28 vendimeve për persona, në 89.28% të tyre gjykatat kanë shpallur personat fajtor sipas aktakuzave, në 10.71% të rasteve janë hedhur aktakuzat para shqyrtimit gjyqësor, në 0% të rasteve të akuzuarit janë liruar nga akuzat dhe në 0% është refuzuar aktakuza.

-Tek rastet e evidentuara si INFORMATA apo PPN-të, në TM4 të vitit 2023 janë pranuar 74 raste të reja kundër 79 personave dhe janë zgjidhur 71 raste kundër 105 personave.

2. KONSTATIMET

- Viti 2023 shënon vitin me rezultatet më të mëdha në sferën e sekuestrimit dhe konfiskimit dhe pa asnjë dyshim paraqet vitin më të mirë të parë ndonjëherë. Shuma prej 23.5 milion euro është dëshmi e një suksesi të tillë, aq më parë nëse kemi parasysh krahasimet me vitet e kaluara;
- Sistemi i drejtësisë ka pasur një progres të jashtëzakonshëm edhe në hetimin dhe gjykimin e veprës penale të shpëaltjes së parave, si vepër penale të vetme, ngase disa raste kanë përfunduar me sukses. Viti 2022 dhe 2023 kanë sjellë disa rezultate në këtë drejtim, raste që janë paraqitur në raporte të mëhershme;
- Në vitin 2023, kemi lansuar edhe Udhëzuesin e Thjeshtësuar për Konfiskimin në Kosovë, që ka të bëjë me zbatimin e dispozitave të konfiskimit në KPRK, KPP, LKZK si dhe rreth hetimeve financiare. Ky Udhëzues do të jetë një ndihmë e madhe për policinë dhe prokurorinë në zbatimin sa më të mirë, efikas dhe unik të dispozitave të tilla;
- Janë publikuar edhe shkresat për secilin nen veç e veç, në mënyrë që të ndihmohet dhe lehtësohet puna e secilit prokuror kur ka të bëjë me zbatimin e ndonjë dispozite të sekuestrimit/konfiskimit;
- Rrjeti i koordinatorëve ka funksionuar në baza të rregullta dhe ka dhënë disa rezultate në këtë drejtim;
- Janë mbajtur trajnime dhe tryeza të rrumbullkta duke diskutuar çështje me rëndësi të dispozitave të sekuestrimit/konfiskimit;
- E kemi dërguar në Gjykatën Supreme, një kërkese për Mendim Juridik, në lidhje me disa probleme në interpretim që janë shfaqur, e që kanë të bëjnë me rrugën që duhet të ndiqet tek
 1. Rruga ligjore apo hapat procedural që duhet të ndiqen tek sekuestrimi i pasurisë së specifikuar,
 2. Rruga ligjore apo hapat procedural që duhet të ndiqen tek sekuestrimi i provave,
 3. Rruga ligjore që duhet të ndiqet tek konfiskimi automatik sipas nenit 276 të KPP-së.
- Në anën tjetër, LKZK vazhdon të mbetet pika më e errët e sistemit të drejtësisë, veçanërisht sistemit prokurorial. PTH Peja ka 5 raste në proces e sipër, një rast tjetër ka përfunduar ashtu që gjykatat kanë refuzuar vazhdimin e procedurës sipas ëktij ligji (më tepër detaje shih në pjesën që i dedikohet LKZK-së). PTH Prizreni ka një rast. Mirëpo, është shqetësuese se prokuroritë tjera kanë zero raste të iniciuara. Për më tepër, ky shqetësim ka të bëjë sidomos me dy prokuroritë më të mëdha, si PSRK dhe PTH Prishtina

që edhe pse kemi më shumë se 5 vite që ky ligj është aprovuar, asnjë rast nuk ka nga këto prokurori. Zbatimi shumë i pakët i LKZK mbetet pika më e dobët e sistemit prokurorial,

- Shitja e aseteve të sekuestruara. Edhe kjo pikë përkundër një progresi, vazhdon të mbetet pikë çalimi dhe shumë asete vazhdojnë të zhvelrësohen pamëshirshëm, si mungesë e zbatimit të mundësisë për shitje në fazë sa më të hershme;
- Zbatimi jo konsistent dhe i pamjaftueshëm i mundësive ligjore të konfiskimit tek një numër i madh i veprave penale. Neni 92 në KPRK vazhdon të zbatohet jo sa duhet, përkundër mundësive tejte të gjera që i ofron. Jo vetëm tek veprat penale të krimeve ekonomike, korrupsionit, narkotikëve etj. por ky nen mund të zbatohet në mënyrë shumë më të gjerë edhe te veprat penale kundër pasurisë, mjedisit, shëndetit etj.

LIGJI MBI KOMPETENCAT E ZGJERUARA TË KONFISKIMIT

LKZK e re ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2019. Çdo aktgjykim që merret pas datës së hyrjes në fuqi, ka mundësi që LKZK e re të aplikohet dhe kjo paraqet një mundësi të mirë për sistemin gjyqësor të vendit që shifrat e konfiskimeve t'i rrisë duke shfrytëzuar këtë ligj që është shumë më i fuqishëm se sa ai i kaluari.

Kështu, PTH Peja, ka 5 raste në proces e sipër sipas këtij ligji, kurse një rast ka përfunduar pa sukses.

Rastet me LKZK janë si në vijim:

1. Në rastin e PTH Prizrenit, aktakuza PP/II.nr.1214-14/21, është ngritur me date 11.05.2023 dhe gjykata ende nuk ka caktuar shqyrtimin fillestar,
2. PTH Peja: PP/I nr. 250/22. Ka të bëjë me rastin për të cilin është ngritur aktakuza për vepër penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve”, nga neni 267 par. 2 i KPRK-së dhe prokurorja ka nxjerr vendimin për hetim për konfiskim, lëshuar urdhrin kufizues të përkohshëm për një lokal 79m2 dhe ka parashtruar kërkesën për urdhër kufizues përfundimtar, e cila kërkesë është refuzuar me arsyetimin se nuk lejohet në këtë fazë aplikimi i LKZK-së dhe i njëjti vendim pas ankesës, është vërtetuar nga ana e Gjykata e Apelit. Pra ky rast tashmë konsiderohet i përfunduar!
3. PP/I nr. 1927/19. Është rasti i pronave, ku i akuzuari është dënuar për vepër penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme dhe në këtë drejtim kemi filluar hetimin për konfiskim, lëshuar urdhrin kufizues

të përkohshëm të ndalimit dhe parashtruar kërkesën për urdhrin kufizues përfundimtar, e cila kërkesë është refuzuar pa ndonjë bazë ligjore për çka edhe kemi parashtruar ankesën. **Ankesën e kemi parashtruar me datën 11.05.2023 mirëpo nga ajo kohë nuk kemi pranuar asnjë vendim nga Gjykata e Apelit.**

4. PP/I nr. 245/16 – i pandehuri është dënuar për vepër penale të fajdesë dhe këtu është nxjerr vendimi për hetim për konfiskim konform LKZK-së dhe jemi në koordinim me hetuesit financiar për pasurinë të cilën e posedon i dënuar, sepse në bazë të raportit të NJIF-it i njëjti posedon pasuri të madhe.
5. PP/I nr. 589/21. Tre pandehurit janë dënuar për vepra penale të fajdesë, mirëpo aktgjykimi akoma nuk është i formës së prerë. Në këtë rast është aprovuar dhe vërtetuar nga Gjykata e Apelit urdhri i përkohshëm i ndalimit dhe tani është lëshuar autorizimi për veprime dhe pasuri shtesë.
6. PP/I nr. 230/21. Është rasti kundër më tepër se 25 të pandehurve për vepra penale të fajdesë dhe në këtë rast ka filluar edhe procedura me LKZK. Ky rast këtë muaj është dërguar dhe pranuar nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës sepse kemi të bëjmë edhe me vepër penale të shpëlarjes së parave për shumë të madhe.
7. Në rastin PP.I.nr.121/2021, për rastin që ka të bëj me veprën penale të fajdesë nga neni 331 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 e lidhur me nenin 77 të KPRK-së si dhe veprës penale pengimi i personit zyrtar nga neni 401 paragrafi 5e lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, tashmë pritët të caktohet seanca dëgjimore për verifikimin epasruisë, që paraqet rastin e parë që pritët ti nënshtrohet një vendimi gjyqësor sipas LKZK-së. Vlen të theksohet se kjo po ndodhë vetëm 5 vite pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Përderisa është pozitive fakti që tashmë po hyjmë në shqyrtimin e parë gjyqësor sipas këtij ligji, nën anën tjetër fakti se janë dashur 5 vite për të pasur rastin e parë, është një tregues negativ se në Kosovë ligjet aprovohet, mirëpo zbatimi i tyre është sfidë në vete.

RAPORT TREMUJOR

Tetor – dhjetor 2023

3. BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Legjislacioni:

Është aprovuar në bordin e BQK -se udhëzuesi për faktorët e rrezikut të PPP/LFT .

Operacionet:

Banka Qendrore e Kosovës gjatë kësaj periudhe raportuese ka kryer 3 inspektime/ekzaminime në fushën PP/FT në institucionet financiare si në vijim:

1. Pro Credit Bank
2. Banka Private e Biznesit
3. Ziraat Banka.

Bashkëpunimi dhe trajnimet:

Ekipi i ekzaminimit ka marre pjese ne :

- Digital Transformation and Fintech, e organizuar nga Shoqata e bankave
- Trajnimi i zyrtarëve të zbatimit të ligjit për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të pastrimit të parave (PP) që lidhen me asetet virtuale (AV), e organizuar nga projekti PECK III- Këshilli i Evropës.
- Vizite studimore ne Gjermani -Bundes Banka.

4. NJËSIA E INTELIGJENCËS FINANCIARE

Sipas mandatit të vet ligjor misioni i Njesisë për Inteligjencën Financiare të Kosovës (NJIF-K) është të udhëheqë përpjekjet e Qeverisë për përmirësimin e parandalimit dhe luftimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në nivel kombëtar. Funksionimi i duhur i sistemit si tërësi, përmes bashkëpunimit të ngushtë institucional dhe aktiviteteve të Njesisë për Inteligjencë Financiare është objektivi kryesor i NJIF-K.

Në dhjetor 2023, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar koncept dokumentin për trajtimin e fushës së parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit. Ky Koncept Dokument analizon legjislacionin dhe masat për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit që ekzistojnë në Kosovë, si dhe nivelin e përputhshmërisë së këtij legjislacioni të Kosovës me Rekomandimet e FATF-së, legjislacionin e BE-së, si dhe nevojën e avancimit të mëtutjeshëm të këtij niveli të pajtueshmërisë.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, NJIF-K së bashku me agjencionet tjera nga Prokuroria, Policia, BQK kanë marrë pjesë në një vizitë studimore me temë "Praktika dhe hetimet në krypto asetë" të mbajtur në Gjermani. Gjithashtu, një vizitë studimore është kryer në UK tek the National Economic Crime Centre (NECC), the UK's FIU, dhe the Joint Money Laundering Investigation Taskforce (JMLIT).

Gjatë vitit 2023, NJIF-K ka identifikuar dhe gjurmuar fonde dhe transaksione që mund të rrjedhin nga aktivitetet e paligjshme, për të cilat ka lëshuar urdhra për ngrirje të përkohshme të transaksioneve në vlerë totale prej rreth 1,649,557 Euro. Pjesa më e madhe e këtyre fondeve janë sekuestruar më pastaj nga Prokuroria.

Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur një sërë takimesh të grupit punues për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2024-2028.

Një sërë trajnimesh e punëtori janë mbajtur nga zyrtarët e NJIF-K, ku ndër më kryesoret janë paraqitur si në vijim:

- Trajnimi i zyrtarëve të zbatimit të ligjit për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të pastrimit të parave (PP) që lidhen me asetet virtuale (AV);
- Operation TENTACLE-Eastern Europe;
- Takimi i rrjetit të përdoruesve të goAML, mbajtur në Vjenë, Austri;
- Pastrimin e parase dhe STR dhe metodatat bashkohore te pastrimit te parasë;
- Octopus Conference;

Gjatë vitit 2023, NJIF-K ka pranuar gjithsej 888 raporte të transaksioneve/aktivitetit të dyshimtë. Në kuadër të bashkëpunimit me agjencionet e zbatimit të ligjit dhe autoritet tjera vendore, mbi bazën e kërkesave për informata, janë shkëmbyer 214 raporte të inteligjencës financiare.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar me homologët e huaj, NJIF-K ka shkëmbyer gjithsej 95 raporte të inteligjencës financiare.

5. POLICIA E KOSOVËS

Policia e Kosovës ka raportuar se gjatë këtij tremujori të katërt ka pasur këto aktivitete të trajnimit:

Nr .	Trajnime , Aktivitet per Pastrim parave ,krime ekonomike Tetor - Dhjetor 2023	Vendi	Organizato r	Nr.trajnime ve	Nr.pjesmarrë sve
1	Trajnim Program i specializuar i trajnimit pastrimi i parave dhe hetimi financiar – Sesioni III	Hotel Sirius - Prishtinë	Akademia e Drejtësisë	1	3
2	Trajnimit Hetimi financiar dhe rikuperimi i aseteve	Prishtinë	Akademia e Drejtësisë me UNDP/SA EK	1	4
3	Trajnim Lidhur me hetimin dhe ndjekjen penale te krimeve financiare	Hotel Dukagjini Peje	Projekti Iniciativa për Sundim të Ligjit në Ballkanin Perëndimor (ËBROLI)	1	5
4	Ëëbinar Luftimi i kontrabandës së emigrantëve me anë të hetimit financiar	Online	CEPOL	1	2
5	Aktivitet Rritjen e Zhvillimit Ekonomik dhe kapitalit njerëzor dhe qëndrueshmërinë dhe mbrojtjen e mjedisit	Shtëpinë e Shoqërisë Civile	Ambasada Amerikane	1	1
6	Trajnim për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të pastrimit të parave (PP) që lidhen me asetet virtuale (AV)	Prishtinë	Projekti i përbashkët i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës kundër Krimit	1	5

			Ekonmik (PECK III)		
total				6	20

Nr .	Trajnime , Aktivitet per Pastrim parave ,krime ekonomike Tetor - Dhjetor 2023 jasht vendit	Vendi	Organizato r	Nr.trajnime ve	Nr.pjesmarrë sve
1	Takim Bashkëpunimi i sektorit privat dhe shkëmbimi i informacionit në hetimet financiare dhe të krimit kibernetik	Turqia	iPROCEED S	1	1
2	Konferencë vjetore për luftimin e financimit të terrorizmit	Belgjika	Komisioni Evropian	1	2
3	Trajnim për trajner (ToT) kundër financimit të terrorizmit	Austria	OSBE	1	2
4	Takim në Kuadër të Grupit teknik për Udhërrëfyesin Rajonal kundër korrupsionit dhe financave të paligjshme në vendet e Ballkanit Perendimor	Kroaci	UNDOC	1	2
5	Takim operacional i Europol-it për luftimin e falsifikimit të parasë	Maqedonia	EUROPOL	1	2
total				5	9

6. STATISTIKAT E NGRIRJEVE, SEKUESTRIMEVE DHE KONFISKIMEVE

Ngrirjet, sekuestrimet, dhe konfiskimet për tremujorin e IV për vitin 2023

Sekuestrim:

Gjatë periudhës raportuese të tremujorit të IV (tetor-dhjetor) për vitin 2023, janë sekuestruar si në vijim:

- 47 automjete.....230,722.06 €
- Para kesh106,620.40 €
- 4 Apartamente, 1 shtëpi, 5 ngastra863,205.50 €
- Të tjera (ari, argjend, pajisje teknologjike, mjete piroteknike, duhan, kafshë, pajisje të ndryshme, masë drunore, kamion, bager, mallra të ndryshme, etj.).....343,448.34 €.

Sekuestrime janë: 1,543,996.30€

Është bërë 1 kërkesë për shitje të automjeteve

PSRK PPS.nr.92/2023

7. SEKUESTRIMET PËR TREMUJORIN E IV-të TË VITIT 2023

Nr.	Nr. i Prokurorisë	Vepra penale	Përshkrimi i pasurisë	Prokuroria	Data
1	PP/II.1960/23	Falsifikim i dokumentit neni 390 të KPRK-së	Automjet	P.Th.Mitrovicë	16.11.2023
2	PP/II.1642/23	Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së	Automjet Mish gjedhi	P.Th.Mitrovicë	09.10.2023
3	PP/II.2125/2023	Tregti e ndaluar 299 të KPRK-së	Automjet Kafshë	P.Th.Mitrovicë	11.12.2023
4	PP/II.1846/23	Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së	Automjet Artikuj ushqimor	P.Th.Mitrovicë	03.11.2023
5	PP/II.nr.2108/23	Tregti e ndaluar 299 të KPRK-së	Automjet Veshmbathje	P.Th.Mitrovicë	07.12.2023
6	PP/II.nr.2110/23	Organizim i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par 2 lidhur me par 1 të KPRK-së	Para Pajisje teknologjike	P.Th.Mitrovicë	08.12.2023
7	PPP/II.nr.849/23	Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së	Automjet Parfume	P.Th.Mitrovicë	21.12.2023
8	PP/II.nr.1839/23	Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së	Automjet	P.Th.Mitrovicë	08.11.2023
9	PP/II.1709/23	Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së	Automjet Artikuj ushqimor	P.Th.Mitrovicë	26.10.2023
10	PP/II.nr.2007/23	Shmangie nga pagesa e tarifave te detyrueshme doganore ose tarifave akcizore nga neni 312 par 5 lidhur me par 1 të KPRK-së	Cigare	P.Th.Mitrovicë	24.11.2023
11	PPN/II.nr.740-5/23	Falsifikim i dokumentit neni 390 të KPRK-së	Automjet	P.Th.Prizren	30.08.2023
12	PPN/II.nr.745-5/23	Falsifikim i dokumentit neni 390 të KPRK-së	Automjet	P.Th.Prizren	01.09.2023
13	PPN/II.nr.960-7/23	Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit neni 338 par 1 te KPRK-se	Automjet	P.Th.Prizren	06.11.2023
14	PP/II.nr.661-7/23	Falsifikim i dokumentit neni 390 të KPRK-së	Automjet	P.Th.Prizren	01.12.2023
15	PPN/II.nr.970-7/23	Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit neni 338 par 1 te KPRK-se	Automjet	P.Th.Prizren	06.11.2023

16	PP/I.nr.166/23	Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paaautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge neni 267 par 1,2 të KPRK-së	Para	P.Th.Prizren	16.11.2023
17	PPN/II.nr.981-4/23	Falsifikim i dokumentit neni 390 të KPRK-së	Automjet	P.Th.Prizren	15.11.2023
18	PP/II.nr.901-7/23		Pije alkoolike	P.Th.Prizren	23.06.2023
19	PP/I.nr.113/2023	Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paaautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge neni 267 par 1,2 të KPRK-së	Para	P.Th.Gjakovë	06.11.2023
20	PPN/II.nr.626/2023	Falsifikim i dokumentit neni 390 të KPRK-së	Automjet	P.Th.Gjakovë	05.12.2023
21	PPN/II.nr.457/23	Vjedhje e pyllit neni 349 par 1 KPRK	Automjet Masë drunore	P.Th.Ferizaj	21.11.2023
22	PP/II.nr.1313/23	Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së	Ari	P.Th.Ferizaj	12.10.2023
23	PPN/II.nr.338/23	Dëmtim i të drejtave pronësore të personit tjetër neni 332 par 1 i KPRK-së	Automjet	P.Th.Ferizaj	05.10.2023
24	PP/II.nr.1736/23	Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së	Stoli argjendi	P.Th.Ferizaj	01.11.2023
25	PPN/II.nr.446/2023	Falsifikim i dokumentit neni 390 të KPRK-së	Automjet	P.Th.Gjilan	13.10.2023
26	PPN/II.nr.482/2023	Shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore ose tarifave akcizore nga neni 312 par 5 lidhur me par 1 të KPRK-së	Material izolues	P.Th.Gjilan	27.10.2023
27	PPN/II.nr.469/2023	Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së	Automjet Duhan i grirë	P.Th.Gjilan	25.10.2023
28	PP/II.nr.1512/2023	Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së	Artikuj ushqimor	P.Th.Gjilan	18.10.2023
29	PP/II.nr.1944/2023	Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së	Veshmbathje	P.Th.Gjilan	28.12.2023
30	PP/II.nr.1954/2023	Tregti e ndaluar 299 të KPRK-së	Leter aramidi	P.Th.Gjilan	29.12.2023
31	PP/II.nr.1793/2023	Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së	Artikuj të ndryshëm	P.Th.Gjilan	29.11.2023
32	PP/II.nr.1825/2023	Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së	Kafshë	P.Th.Gjilan	01.12.2023
33	PP/II.nr.1608/2023	Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së	Duham	P.Th.Gjilan	09.11.2023
34	PP/II.nr.1611/2023	Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së	Automjet Mjete piroteknike	P.Th.Gjilan	09.11.2023
35	PP/II.nr.2470/23	Vjedhje neni 313 par 1 të KPRK-së	Para	P.Th. Pejë	13.12.2023
36	PPN/II.nr.797/23	Vjedhje e pyllit neni 349 par 1 KPRK	Automjet Masë drunore	P.Th. Pejë	24.10.2023
37	PPN/II.nr.915/23	Legalizim i përmbajtjes së rreme neni 395 i KPRK-së	Automjet	P.Th. Pejë	04.12.2023
38	PPN/II.nr.916/23	Vjedhje e pyllit neni 349 par 1 KPRK	Rimorkio Masë drunore	P.Th. Pejë	04.12.2023
39	PP/II.nr.2197/2023	Vjedhje e pyllit neni 349 par 1 KPRK	Masë drunore	P.Th. Pejë	08.11.2023
40	PPN/II.nr.872/2023	Legalizim i përmbajtjes së rreme neni 395 i KPRK-së	Automjet	P.Th. Pejë	17.11.2023
41	PPN/II.nr.776/2023	Vjedhje e pyllit neni 349 par 1 KPRK	Masë drunore	P.Th. Pejë	19.10.2023
42	PP/II.nr.2046/2023	Vetëgjyqësia neni 410 i KPRK-së, Lëndim i rëndë trupor neni 186 i KPRK-së	Automjet	P.Th. Pejë	19.10.2023
43	PPN/II.nr.732/23	Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit neni 338 par 1 te KPRK-se	Kamion/Luge ngarkuese/ Bager Volvo/pajisje seperacioni	P.Th. Pejë	19.10.2023
44	PP/I.nr.96/23	Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paaautorizuar e narkotikëve,	Para	P.Th. Pejë	24.10.2023

		substancave psikotrope dhe analoge neni 267 par 1,2 të KPRK-së			
45	PPN/I.nr.269/2023	Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge neni 267 par 1,2 të KPRK-së	Para	P.Th. Pejë	17.11.2023
46	PP/I.nr.117/2023	Dhunimi neni 227 par 4, nën par 4.6 dhe nën par 4.7 lidhur me par 1 dhe nenin 31 të KPRK-së	Automjet	P.Th. Pejë	15.12.2023
47	PP/I.nr.121/2021	Fajde neni 331 par 3 lidhur me par 1 dhe neni 77 të KPRK-së, Pengim i personit zyrtar neni 401 par 5 të KPRK-së (LKZK)	4 ngastra bujqesore + 1 shtëpi 3 apartamente 3 automjete	P.Th. Pejë	01.11.2023
48	PPS.nr.78/2023	Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse neni 364 par 2 lidhur me par 1 dhe nenin 31 të KPRK-së	Automjet Para	PSRK	11.10.2023
49	PPS.nr.92/2023	Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale neni 333 par 1, Falsifikimi i parasë neni 296 par 1, Shpërlarje e parave neni 302 I KPRK-së	Automjet	PSRK	11.12.2023
50	PPN.nr.188/2023		Para	PSRK	16.11.2023
51	PPS.nr.65/2023	Detyrimi neni 328 par 1 lidhur me par 2 të KPRK-së, Fajde neni 331 par 1 lidhur me par 3 të KPRK-së, Mashtrim neni 323 par 1 lidhur me par 4 të KPRK-së, Krim i organizuar neni 277 par 1 të KPRK-së, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve neni 366 par 2 i KPRK-së	Automjet Para	PSRK	12.10.2023
52	PPS.nr.84/2023	Mashtrim neni 232 i KPRK-së	Para	PSRK	03.11.2023
53	RLN/II.nr.1371/23	Falsifikim i dokumenteve 390 i KPRK-së	Automjet	P.Th.Prishtinë	25.10.2023
54	RLN/II.nr.1397/23	Falsifikim i dokumenteve 390 i KPRK-së	Automjet	P.Th.Prishtinë	07.11.2023
